




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



N.T.SH. "ONE"

Nr. i biznesit 70973146

Pronare – Neshe KRASNIQI

OK "N.T.SH. ONET"

Bilushë

Prizren

Ref: 1310/1474/KPM/II

VENDIM

për refuzimin e licencimit të operatorit kabllorë, N.T.SH. "ONE" – Bilushë, Prizren

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj, në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Në bazë të Nenit 5 të Rregullores CIMC 2007/04, operatorët aktivë kabllorë kanë qenë të obliguar të regjistrohen një muaj pas miratimit të kësaj rregulloreje, ndërsa tre muaj më vonë kanë qenë të obliguar të aplikojnë për licencë të KPM-së.
3. Kandidati për operatorë kabllorë N.T.SH. "ONE" ka aplikuar për licencë të KPM-së, për operatorë kabllorë, më datën 11 dhjetor 2013.
4. Me qëllim të vërtetësisë dhe vlefshmërisë së dokumentacionit të parashtruar për kërkesë, më datën 15 maj 2014 KPM ka nxjerrë udhëzimin për plotësim të dokumentacionit përkatës. Kandidati për licencë të KPM-së N.T.SH. "ONE", nuk ka vepruar në pajtim me udhëzimin e lartcekur të KPM-së për plotësimin e kërkesës së parashtruar.

1/2

Arsyetim

5. Ligji Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, përcakton se KPM është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit si dhe rregullon të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësit e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbime mediale audio-vizuale.
6. Neni 21, paragrafi 1 i Ligjit të KPM-së përcakton se: *“për të ushtruar transmetim në Kosovë sipas kushteve të këtij ligji kërkohet licenca për transmetim, të cilën e lëshon KPM-ja”*.
7. KPM vlerëson se, kandidati për operatorë kabllorë N.T.SH. “ONE”, nuk i ka përmbushur kriteret për kualifikim për licencë të KPM-së pasi që nuk ka arritur që brenda afatit të përcaktuar me udhëzimin e KPM-së, ti sjellë dokumentet e vërtetuara dhe dokumentet e vlefshme sipas afatit dhe në këtë mënyrë nuk ka plotësuar kërkesën e tij në pajtim me udhëzimin.

VENDIM

8. KPM merr vendim që kandidatit të interesuar për licencë të operatorit kabllorë N.T.SH. “ONE”, i cili planifikon të operojë në disa fshatra në Komunën e Prizrenit, t’i refuzoj kërkesën për licencën e KPM-së për operatorë kabllorë, për të ofruar shërbime të programeve përmes rrjetit kabllorë.
9. Ky vendim, nuk e përjashton mundësinë e kandidatit N.T.SH. “ONE” që të aplikojë në të ardhmen për licencë të KPM-së.

Lëshimi i Vendimit

10. Këtë vendim e lëshon Komisioni i Pavarur i Mediave dhe i njëjti është i vlefshëm që nga data e nënshkrimit të tij.


Adnan MEROVCI
Kryetar
Komisioni i Pavarur i Mediave



11.06.2014
datë